



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 21 të ligjit Nr. 04/1-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 18 të ligjit Nr. 04/1-110 për Ndërtim, nenit 21, 22, 44, 50 dhe 84 të ligjit Nr. 05/1-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 17, pika "d" të ligjit Nr.03/1-040 për Vetëqeverisjen lokale, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, duke vendosur sipas kërkesës me nr. 05-350/03-217863/23 dt. 08.11.2023, të aplikuesve/bashkëpronarëve Merve Maskuka-Fatjani, Errëzana Spahi, dhe Xhevahire Haskuka-Krasniqi nga Prizreni dhe investitorit "Kosova Home" shpk, me seli në Prishtinë, rr. "Xhavit Mitrovica" obj.2/2 në Prishtinë, për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të kushteve ndërtimore, të caktuara me "Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 NR. 350/02-145489/20 të dt. 01.09.2021, nga kjo drejtori, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit në kuadër të Planit Zhvillimor Urban-PZHU, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me dt. 13.06.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLOTËSIMIT DHE NDRYSHIMIT TË AKTIT ADMINISTRATIV
"VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE" 05 NR. 350/02-145489/20 të dt.
01.09.2021

I. Miratohet kërkesa 05-350/03-217863/23 dt. 08.11.2023, në emër të aplikuesve/bashkëpronarëve Merve Maskuka-Fatjani, Errëzana Spahi, dhe Xhevahire Haskuka-Krasniqi nga Prizreni dhe investitorit "Kosova Home" shpk, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810008195, për ndryshimin/plotësimin e kushteve ndërtimore të caktuara me aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 NR. 350/02-145489/20 të dt. 01.09.2021, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit.

II. Ndryshohet dhe plotësohet "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 NR. 350/02-145489/20 të dt. 01.09.2021, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, në emër të të aplikuesve/bashkëpronarëve Merve Maskuka-Fatjani, Errëzana Spahi, dhe Xhevahire Haskuka-Krasniqi nga Prizreni dhe investitorit "Kosova Home" shpk, me seli në Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, gjithsejtë 18 shtëpi banim ore, të sistemuara sipas tipeve: Tipi "1" - 1 shtëpi, Tipi "2" - 6 shtëpi, Tipi "3" - 1 shtëpi, Tipi "4" - 1 shtëpi, Tipi "9" - 7 shtëpi, të gjitha me etazhitet P+1, dhe Tipi "6" - 1 shtëpi dhe Tipi "7" - 1 shtëpi, me etazhitet B+P+2, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban-PZHU në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale, nr. 552-14 ZK. Prishtinë, sipas projekt propozimi/plani i situacionit-"zgjdhjes urbane" të prezantuar në këtë drejtori.

Plotësimi dhe ndryshimi bëhet me paragrafin f) dhe g) të pikës IV. dhe pikën V. të "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 NR. 350/02-145489/20 të dt. 01.09.2021 dhe pjesës grafike-situacioni të këtyre kushteve, dhe ka të bëjë me:

- zëvendësimin i 2 shtëpive të tipit "6" dhe "7", të planifikuara sipas kushteve ndërtimore, në parcelat kadastrale me nr. 552-28 dhe 552-29 ZK. Prishtinë, me një shtëpi të tipit "6" me etazhitet B+P+2, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimore S=415.23 m², e shpërndarë nëpër

etazhe: bodrum $S=104.86\text{ m}^2$, përdhese me $S=103.61\text{ m}^2$, kati I-rë me $S=109.07\text{ m}^2$ dhe kati II-të me $S=97.69\text{ m}^2$,

- ISHP- Indeksi i shfrytëzimit të parcelës i lejuar është max. 30%, ndërsa sipas Vendimit nr.01-031-185481 dt. 14.08.2015 të Kryetarit të Komunës për zhvillimin e arkitekturës së qëndrueshme lejohet deri në 40% (vendim të cilin pala e ka propozuar për aplikim);
 $S=470 \times 0.3=141\text{ m}^2$ / sipas Planit Zhvillimor Komunal /,
 $S=103.61\text{ m}^2$ sipas Projekt Propozimit.
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës (ISHPN), për vendosjen e shtëpisë në bazë-gabarit të bodrumit është max. 60%, bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01nr.031-185481 dt.14.08.2015, me kushtin që pjesa e nëntokës që shtrihet jashtë gabaritit, nuk mund të tejkalojë nivelin e truallit.
 $S=470 \times 0.6=282\text{ m}^2$ / sipas Planit Zhvillimor Komunal /,
 $S=104.86\text{ m}^2$ sipas Projekt Propozimit,
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (GSI), bazuar në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.4 (40%), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (30%), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:
 $S=470 \times 0.4=188\text{ m}^2$ / sipas Planit Zhvillimor Komunal /,
 $S=188.0\text{ m}^2$ sipas Projekt Propozimit,
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Zhvillimor Urban-PZHU, është $0.6 \div 0.8$. Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: 100% për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , 50% për etazhet me vëllim mbi 51% apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - suterren, dhe 0% për etazhet e nëntokës, dhe sipas llogarive, kjo sipërfaqe është:
 $S=470 \times 0.6=282\text{ m}^2$
 $S=470 \times 0.8=376\text{ m}^2$
 $S=310.37\text{ m}^2$ sipas Projekt Propozimit.

III. Ndarja/parcelimi, i parcelës kadastrale nr. 552-29 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas parcelave ndërtimore dhe rrugëve të planifikuara, të përcaktuara me vijën rregulluese, bazuar në Plani i situacionit-“zgjdhja urbane” dhe manualin e ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar Luan Islami, me licencë nr. 185.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekur, sipas Planit të situacionit-“zgjdhja urbane” dhe manualit të ndarjes. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit-“zgjdhja urbane” dhe manualin e ndarjes së parcelave, punuar nga kompania gjeodete e licencuar, e i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

IV. Bashkimi i parcelave kadastrale nr. 552-28 dhe 552-29 ZK. Prishtinë, për krijimin e parcelës ndërtimore të bëhet duke u bazuar edhe në Plani i situacionit - “zgjdhja urbane” dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin/ndarjen e parcelave të lartcekura sipas, Planit të situacionit-“zgjdhja urbane” dhe manualit të bashkimit të parcelave, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit/ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtij vendimi dhe me kërkesë të pronarëve, duke u bazuar në Plani i situacionit-“zgjdhja urbane” dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

V. Me këtë Vendim Ndryshohen dhe Plotësohen Kushtet Ndërtimore të miratuara me “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 NR. 350/02-145489/20 të dt. 01.09.2021, për ndërtimin e

kompleksit të shtëpive individuale të banimit, dhe i njëjti prodhon efekte juridike nga dita e lëshimit të këtij Vendimi.

A r s y e t i m

Aplikuesit/bashkëpronarët Merve Maskuka-Fatjani, Errëzana Spahi, dhe Xhevahire Haskuka-Krasniqi nga Prizreni dhe investitorit "Kosova Home" shpk, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810008195, me kërkesën 05-350/03-217863/23 dt. 08.11.2023, i janë drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit, të Komunës së Prishtinës, për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 NR. 350/02-145489/20 të dt. 01.09.2021, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, në emër të në emër të të aplikuesve/bashkëpronarëve Merve Maskuka-Fatjani, Errëzana Spahi, dhe Xhevahire Haskuka-Krasniqi nga Prizreni dhe investitorit "Kosova Home" shpk, me seli në Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, gjithsejtë 18 shtëpi banim ore, te sistemuara sipas tipeve: Tipi "1" - 1 shtëpi, Tipi "2"- 6 shtëpi, Tipi "3"-1 shtëpi, Tipi "4"- 1 shtëpi, Tipi "9"- 7 shtëpi, te gjitha me etazhitet P+1, dhe Tipi "6" - 1 shtëpi dhe Tipi "7" - 1 shtëpi, me etazhitet B+P+2, në lokacionin e përshkruar në pikën I. të këtij Vendimi.

Bashkangjitur me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar:

- Kopjet e planit dhe fletat poseduese për parcelën kadastrale nr. 552-28 dhe 552-29 ZK. Prishtinë, të evidentuar në certifikatat e njësisve kadastrale;
- Aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 NR. 350/02-145489/20 të dt. 01.09.2021;
- Projekti konceptua-"zgjdhja urbane" për kompleksin e propozuar, i hartuar nga kompania projektuese NPSH "Smart Project", me seli në Prishtinë, dhe me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 70275674;
- Manualin gjeodezik për ndarjen dhe bashkimin e parcelave kadastrale nr. 552-28 dhe 552-29 ZK. Prishtinë, punuar nga gjeodeti i licencuar Luan Islami, me licencë nr. 185;
- Akti noterial "Autorizimi Përgjithshëm", dhënë nga "Kosova Home" shpk, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Hasan Canolli nga Prishtina, për subjektin juridik "Smart Project", me seli në Prishtinë, për përfaqësim, i redaktuar dhe noterizuar te noterja Ermira Uka Gashi në Fushë Kosovë, LRP.nr. 5449/2019 dt. 06.05.2019;
- Akti noterial "Autorizim", dhënë nga kompania NPSH "Smart Project", me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Sabahidin Veseli nga Dragashi, për Gonxhe Zeqirin nga Prishtina, për përfaqësim të kompanisë NPSH "Smart Project", i redaktuar dhe noterizuar te noterja Arbena Shehu në Prishtinë, LRP.nr. 4604/2016 dt. 29.07.2016;
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të "Kosova Home" shpk, nr. 810008195;
- Fotokopja e letërnjoftimit të aplikuesve/bashkëpronarëve, investitorit dhe të autorizueses.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05-350/03-217863/23 dt. 08.11.2023, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, Planin Zhvillimor Komunal-PZH, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual - projektit ideor, me planin e situacionit - "zgjdhja urbane", ka konstatuar se:

Drejtorja e Urbanizmit duke vendosur, sipas kërkesës nr. 05 NR. 350/02-145489/20 dt. 19.08.2020, me Aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 NR. 350/02-145489/20 të dt. 01.09.2021, aplikuesve/bashkëpronarëve Merve Maskuka-Fatjani, Errëzana Spahi, dhe Xhevahire Haskuka-Krasniqi nga Prizreni dhe investitorit "Kosova Home" shpk, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810008195, i ka caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, gjithsejtë 18 shtëpi banimore, te sistemuara sipas tipeve: Tipi "1" - 1 shtëpi, Tipi "2"- 6 shtëpi, Tipi "3"-1 shtëpi, Tipi "4"- 1 shtëpi, Tipi "9"- 7 shtëpi, te gjitha me etazhitet P+1, dhe Tipi "6" - 1 shtëpi

dhe Tipi "7" - 1 shtëpi, me etazhitet B+P+2, ne kuadër te Planit Zhvillimor Urban-PZHU në Prishtine, konkretisht ne kuadër te parcelës kadastrale, nr. 552-14 ZK. Prishtine, sipas projekt propozimit/plani i situacionit- "zgjidhjes urbane" te prezantuar ne ketë drejtori.

Pronaret pas rregullimit të parcelave në fjalë sipas "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 NR. 350/02-145489/20 të dt. 01.09.2021, dhe krijimit të parcelave sipas zgjidhjes urbane me kërkesën nr. 05-351/02-281289/21 dt. 29.12.2021, kanë kërkuar nga kjo Drejtori lejimin e ndërtimit të kompleksit të shtëpive në fjalë, ku bazuar në kërkesë kjo drejtori me Aktin administrativ "Vendimin për lejimin e ndërtimit nr. 05 nr. 351/02-281289/21 DT. 28.10.2022, pronareve Merve Haskuka-Fatjani, Errëzana Spahi, dhe Xhevahire Haskuka-Krasniqi nga Prizreni, dhe investitorit "Kosova Home" shpk, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810008195, dhe me përfaqësues Hasan Canolli nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 351/02-281289/21 dt. 29.12.2021, ju ka lejuar ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale për banim gjithsejtë 14 shtëpi familjare – Tipi "1" – 1 shtëpi, Tipi "2"- 6 shtëpi, Tipi "3"- 1 shtëpi, Tipi "4"- 1 shtëpi, dhe Tipi "5"- 5 shtëpi, me etazhitet P+1 dhe -B+P+1, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 552-20, 552-21, 552-22, 552-23, 552-24, 552-25, 552-26, 552-27, 552-34, 552-35, 552-36, 552-37, 552-38 dhe 552-39 ZK Prishtinë. Në procedurë të shqyrtimit të kësaj kërkesë kjo drejtori ka konstatuar se në "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 NR. 350/02-145489/20 të dt. 01.09.2021, është lëshuar gabim teknik për 2 shtëpitë të tipit "6" dhe "7", të planifikuara sipas këtyre kushteve, për parcelat kadastrale me nr. 552-28 dhe 552-29 ZK. Prishtinë, pasi që sipërfaqja prej S=68 m2, kalon në infrastrukturë rugore të planifikuar sipas PZHU-së, ku dhe është udhëzuar pala se duhet të paraqes kërkesë për plotësim dhe ndryshim të këtyre kushteve ndërtimore.

Bazuar në këtë udhëzim, kjo drejtori ka pranuar kërkesën 05-350/03-217863/23 dt. 08.11.2023, në emër të aplikuesve/bashkëpronarëve Merve Haskuka-Fatjani, Errëzana Spahi, dhe Xhevahire Haskuka-Krasniqi nga Prizreni dhe investitorit "Kosova Home" shpk, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810008195, për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të kushteve ndërtimore të caktuara me "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore" 05 NR. 350/02-145489/20 të dt. 01.09.2021, përkatësisht zëvendësimin e dy shtëpive të banimit për parcelat kadastrale 552-28 dhe 552-29 ZK. Prishtinë, të njëjtat të planifikuara me kushtet ndërtimore të cekura më lartë, duke planifikuar ndarjen dhe bashkimin e këtyre dy parcelave në një parcelë ndërtimore dhe ndërtimin e ndërtesës të tipit "6" me etazhitet B+P+2.

Ky organ, pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe provave të bashkëngjitura, identifikimit të gjendjes faktike në terren, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësiror për hapësirën ku gjendet lokacioni si dhe të rregullativës ligjore në fuqi, nga lëmi i ndërtimit dhe asaj nga lëmi i procedurës së përgjithshme administrative, vendosi të miratojë ndryshimet e bëra, sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Shtojcë: Situacioni i ngushtë, me plotësimet dhe ndryshimet e miratuara dhe manuali gjeodezik të ndarjes dhe bashkimit.


Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do ti përcillet organit epror – MMPHI-së.

Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesve/Investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 NR. 350/02-145489/20 dt. 19.08.2020 dhe 05-350/03-217863/23 dt. 08.11.2023.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

DREJTORIA E URBANIZMIT, E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr. 350/02-145489/20 DT. 13.06.2024

Zyrtari,
Mimoza Berisha Prestreshi



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazim Krasniqi



Faqe 4 prej 4

Komuna e Prishtinës
Drejtorija e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosova
 Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/Ministry of Infrastructure and Environment
 AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: 00552-28


Zona kadastrale / Katastarska zona: Prishtinë

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1 : 500

Propozim për Ndarjen e Parcelave





Nr.	Y(m)	X(m)
1	7511921.740	4725282.549
2	7511928.226	4725281.881
3	7511938.496	4725269.318
4	7511942.393	4725264.550
5	7511948.050	4725257.629
6	7511949.624	4725255.704
7	7511936.007	4725249.867
8	7511931.254	4725249.878
9	7511928.647	4725252.058
10	7511926.229	4725255.694
11	7511924.679	4725258.024
12	7511921.141	4725263.343
13	7511920.311	4725265.227
14	7511920.168	4725267.280
15	7511927.585	4725254.257
16	7511929.153	4725253.402
17	7511930.955	4725253.044
18	7511932.865	4725253.272

Rilevoi / Snimio: Luan Islami
 (emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Aprovoi / Usvujio: _____
 (emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nr. i licencës / Br. licence: 185


Mbështetimi / Datum:



PROJECT: 'Kosovo Home Residence' Arberi, Prishtinë
 Logje Bonimi Individuali - Tipi 6

SMART PROJECT
 ARCHITECTURE
 CONSULTANTS

EMRANETIA	
NOI FAKTORI	Sabohden Veseli Bashni Shyqeriu
KONSTRUKTORI	Sabohden Veseli Bashni Shyqeriu
PRORAJEKTOR	Gentill Fejzullari Bekim Berisha
DATA	Qeshor 2023



KOSOVA HOME RESIDENCE	PROJEKTI	A	PROJEKTAR	SMART PROJECT BUA	PROJEKTOR	KOSOVA HOME RESIDENCE
			PROJEKTI	ARKITETURA	PROJEKTOR	SMART PROJECT BUA
KOSOVA HOME RESIDENCE - ANEKL, AKBIL			SMART PROJECT BUA			KOSOVA HOME RESIDENCE
LCC/BE BERTINI INDIVIDUAL - I/BI/6			SMART PROJECT BUA			KOSOVA HOME RESIDENCE
LCC/BE BERTINI INDIVIDUAL - I/BI/6			SMART PROJECT BUA			KOSOVA HOME RESIDENCE
LCC/BE BERTINI INDIVIDUAL - I/BI/6			SMART PROJECT BUA			KOSOVA HOME RESIDENCE

Situational I ngurih

SMART PROJECT

KOSOVA HOME RESIDENCE